



A.nr.244/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, më Avdyl Bekteshi në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.244/2026, të datës 04.03.2026, të parashtruar nga ankuesja, N.K, nga Gjilani, kundër organit: Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 04.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.244/2026, e datës 04.03.2026, e parashtruar nga ankuesja N.K.

II. Mbetet në fuqi Akt/Njoftimi me numër protokolli 02-016-14128 i datës 23.02.2026, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Komunës së Gjilanit, lidhur më shpalljen e kandidatit fitues në procedurën e pranimi më numër të referencës: RN00019142.

III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pranë Komunës së Gjilanit, që në procesin e verifikimit përfundimtar para emërimit sipas nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që emërimi i kandidatit/es fitues/e të behët vetëm pas sigurimit të dëshmimeve përkatëse lidhur me kriteret formale siç përcaktohet më këto dispozita ligjore.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën III të dispozitivit.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil N.K. (*tutje referuar ankuesja*), më datë 04.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimi më numër të referencës RN00019142, për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita *Zyrtar i Lartë për Hidroteknikë*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së

Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa, ky kjo e fundit ka dërguar përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje të drejtë dhe meritorë administroi si prova relevante: Ankesën me numër protokolli 1132/2026 e datës 04.03.2026, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për kandidatin fitues; Njoftimin nga SIMBNJ; Kopjen e ID-së së ankuses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës; Përgjigjen në ankesë; Njoftimin për testim me shkrim; Konkursin me Nr. Reference: RN00019142; Kërkesën për fillimin e rekrutimi; Njoftimin për verifikim paraprak; Vendimin për themelimin e Komisionit të pranimit dhe akt emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Aplikacionin e kandidatës fituese; Aplikacionin e ankuses; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës; email-kërkesa e KMPSHCK-së drejtuar NBNJ të Komunës së Gjilanit e datës 03.08.2026, email përgjigja e datës 03.08.2026 (plani i personelit) të Komunës së Gjilanit; email-kërkesa e KMPSHCK-së drejtuar DMZP-së i datës 03.08.2026; email përgjigja e datës 03.08.2026, e DMZP-së(testi i ankuses).

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara, *sepse*:

Gjendja e fakteve:

Nga provat e administruare rezulton:

-Komuna e Gjilanit më datë 18.12.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00019142, për Grupin i Inxhinierisë së Ndërtimit, kategoria Specialist, pozita *Zyrtar i Lartë për Hidroteknikë* në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim, më afat të aplikimit nga data 19.12.2025 deri më datë 17.01.2026.

-Në këtë procedurë rekrutimi sipas njoftimit të datës 23.01.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe specifike kanë qenë tre (3), përfshira edhe ankuesen dhe mbi këtë bazë, e njëjta i është nënshtruar fazës së vlerësimit përmes testit me shkrim, mirëpo, mirëpo e njëjta kishte arritur vetëm 27 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar më intervistën më gojë.

-Më datë 23.02.2026 Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjilanit, ka shpallur njoftimit përfundimtar për kandidatin fitues, ku sipas të cili akti rrjedhë së K.T-A me gjithsej 95.6 pikë, të jetë kandidate fituese.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se ka pasur parregullsi gjatë mbajtjes së testimit me shkrim duke mos qëndruar anëtarët e komisionit prezent gjatë testimit me shkrim. Tutje pretendon në trajtim jo të barabartë të kandidateve, si dhe e drejta për ankimim pas çdo faze të

procedurës nuk është respektuar, respektivisht pas testimit me shkrim. Kërkon që të verifikohet prezenca e anëtarëve të komisionit gjatë testimit; Qasjen në evidencën elektronike të testit për çdo kandidat; Rishikimin e procedurës se intervistës nëse është mbajtur pasafatit të ushtrimit të drejtës në ankesë; Pezullimin e procedurës se punësimit deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës; Në rast të konstatimit të parregullsive, anulimin dhe përsëritjen e testit dhe procedurës së konkursit.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen konkursit publik me numër reference RN00019142, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinieri e ndërtimit, inxhinieri strukturore, inxhinieri arkitekture, inxhinieri gjeoteknike, hidroteknike. Përvoja e punës e kërkua:* *Së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në ndërlidhje me bazushmerinë e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publike, me theks të veçantë:

- Nenit 9 paragraf 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkua për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj.*

- Nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: 7. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.. 12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin*

e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..”

-Neni 42: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitën e specialistes/it, bëhet nga komisioni i pranimit për kategorinë e specialistes/it. 2. Komisioni i pranimit për kategorinë e specialistes/it ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse për pozitën apo grupin e pozitave për të cilat zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/es nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) profesore/r i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- Neni 7: Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

-Neni 8: Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.

-Neni 9: Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas

rekomandimeve të Komisionit të Pranimiit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Nenit 10: Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimiit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimiit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimiit mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimiit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të marrë më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.

-Nenit 11: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimiit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka analizuar provat materiale të çështjes dhe për rrjedhojë konstatoi se kriteret formale janë në pajtim me grupin e pozitës Inxhinieri e Ndërtimit dhe se Komisioni i Pranimiit i themeluar sipas Vendimit nr.prot:89, të datës 09.02.2026, të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore sipas nenit 42 të LZPS-së. Ndërsa, në ndërlidhje me pretendimet ankimore përkitazi me fazën e vlerësimit, Kolegji bazuar në provat e shqyrtuara vlerëson së nuk kanë mbështetje ligjore, mbi arsyet se testimi me shkrim zhvillohet në mënyrë elektronike dhe Këshilli tashmë ka qëndrim të konsoliduar se mos prezenca e ndonjërit nga anëtarëve gjatë mbajtjes së testit nuk përbën në vete shkelje ligjore, sepse, procesi i testimit mund të menaxhohet edhe nga disa anëtarë të komisionit. Ndërsa, lidhur me të drejtën e ankesës në çdo fazë të konkursit një pretendim të tillë po ashtu nuk është i bazuar nisur nga përcaktimi ligjor sipas nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L197 për Zyrtarët Publikë, pasi që kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit kanë të drejtë ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, e mbi këtë bazë

për zhvillimin e procedurës së intervistës më gojë nuk ka qenë e nevojshme të pritet ndonjë afat për ankesë.

Referuar pretendimit të ankueses për krahasim të pikëve të testit më shkrim më kandidaten e shpallur fituese, Kolegji ka analizuar testet e dy palëve, nga dhe ka gjetur së ankuesja ka dhënë 8 përgjigje të sakta tek pyetjet më shumë opsione, duke grumbulluar 16 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), vlerësim ky që behët nga sistemi elektronik, ndërsa, në ese si vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimi, ankuesja është vlerësuar më 11 pikë nga 20 pikët maksimale, duke arritur në total 27 pikë, kurse, kandidatja fituese K.T-A, ka dhënë 25 përgjigje të sakta tek pyetjet më shumë opsione, duke grumbulluar 50 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), ndërsa, në ese është vlerësuar me 17.4 pikë duke grumbulluar gjithsej 67.4 pikë. Andaj, mbi këto rrethana, Kolegji nuk mund të vërtetoj ndonjë parregullsi në kuptim të diferencës së pikëve të kandidatës fituese dhe ankueses, pasi që ankuesja edhe sikurse në ese të ishte vlerësuar më 20 pikët maksimale e njëjta serish nuk do arrinte kuotën e nevojshme prej 50 pikëve për të kaluar testin më shkrim, sepse, siç u theksua më sipër ankuesja ka akumuluar vetëm 16 pikë të pyetjet me opsione (16 pikë përgjigje të sakta + 20 pikë eseja/ 36 pikë).

Përkitazi me kërkesën e ankueses për qasje në log-et dhe evidencën elektronike të testit për çdo kandidatë mbi bazën e diskriminimit, Kolegji rikujton palën ankuese së duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-081 Për Qasje në Dokumente Publike, ka poseduara të drejtën e parashtrimit të kërkesës në qasje në dokumentet respektive tek Komuna e Gjilanit.

Në vështrim të parimit të meritokacisë si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, Kolegji ka analizuar aplikacionin e kandidatës fituese (i dorëzuar më rastin e përgjigjes në ankesë) të datës 24.12.2025, nga dhe ka gjetur së kandidatja K.T-A lidhur me kriterin e arsimit ka bashkangjitur Diplomën me Nr.1460, të datës 02.12.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundimin e studimeve themelore më datë 24.11.2016, në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës-Departamenti i Ndërtimtarisë, ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës ka bashkangjitur: Referencën e Punës (pa datë), të lëshuar nga pronari i kompanisë “Green Door” Sh.P.K, sipas të cilës konfirmohet së kandidatja në fjalë është e punësuar në këtë kompani si Inxhinierë e Hidroteknikës nga data 01.08.2019; Letër referencën e datës 12.12.2022, të lëshuar nga kompania “Design Project”, më të cilin theksohet se K.T-A, është e angazhuar pranë kësaj kompanie nga janari 2021 dhe Referenca. Nr.642 të datës 17.08.2025, të lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Gjilanit, sipas të cilës dëshmi është vërtetuar së kandidatja K.T-A ka qenë e angazhuar në këtë komunë, më kontratë mbi vepër si zyrtare e Hidroteknikës edhe atë nga data 01.12.2024 dhe vazhdon të punoj, përvojë të cilën ankuesja e mbështet më Pasqyrë të Trustit të datës 23.12.2025, ashtu që, sipas kësaj dëshmi rrjedhë së kandidatja ka të paguar kontributet tek kompania Green Door për periudhën korrik -dhjetor 2019, janar-prill 2020, qershor-dhjetor 2020, nëntor-dhjetor 2021, janar-dhjetor 2022, dhe janar-gusht 2023, tek kompania Design Project për periudhën nëntor-dhjetor 2021, janar, mars-dhjetor 2022, dhe janar-shkurt 2023, kurse lidhur më angazhimin në Komunën e Gjilanit, rrjedhin pagesa vetëm për periudhën dhjetor 2024 deri qershor 2025. Pra, mbi gjendjen e këtyre dëshmime rrjedhë së kandidatja e shpallur fituese ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë së e njëjta në fazën e vlerësimit ka arritur gjithsej 95.6 pikë të përgjithshme, duke u renditur si kandidatja me më së shumti pikë të mbledhura, atëherë,

e njëjta konsiderohet edhe si kandidate e suksesshme për këtë procedurë të pranimi, kështu që, mbi këtë bazë njësia përgjegjëse në Komunën e Gjilanit ka vepruar pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me rastin e shpalljes si kandidate fituese.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se procedura e pranimi për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Hidroteknikë*, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.244/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, N.K;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*